

# KARANTINË SHTEPIAKE -


FRENIMI I PERHAPJES SË KORONËS

Albanisch




## CFARË DO TË THOTË „KARANTINË SHTEPIAKE“?

Karantina shtëpiake do të thotë që ju duhet të izoloheni në shtëpi për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të virusit Corona. Gjatë kësaj kohe nuk ju lejohet të keni asnjë kontakt me askënd përveç familjes suaj. Kjo do të thotë: ju duhet të qëndroni në shtëpi dhe të mos pranoni asnjë vizitor.



## KUR JAM I/E DETYRUAR TË HY NE KARANTINË SHTEPIAKE?

Në karantinë duhet të hyni atëherë kur departamenti i shëndetësisë e urdhëron atë. Juve do të ju jepet një letër nëse keni rezultuar pozitiv për virusin Corona ose nëse ekziston dyshimi se mund të jeni infektuar nga një person.

Kjo letër titullohet “Maßnahmen gemäß § 28 Abs. 1 Satz 1 und § 30 Abs. 1 Satz 2 Infektionsschutzgesetz (IfSG). Hier: Anordnung der Absonderung in sogenannter häuslicher Quarantäne (Masat në përputhje me Seksionin 28 Paragrafi 1 Fjalë 1 dhe Seksioni 30 Paragrafi 1 Fjalë 2 i Aktit të Mbrojtjes së Infeksionit (IfSG). Këtu: rregullimi i izolimit në të ashtuquajturën karantinë shtëpiake)”.  


## MË LEJOHET GJATË KARANTINËS TE DAL NË PAZAR, TË SHKOJ TE MJEKU APO TË DAL ME SHËTIT?

Fatkeqsishtë JO! Nuk ju lejohet të bëni pazar gjatë karantinës. Pyesni anëtarët e familjes (të cilët nuk janë në karantinë), miqtë ose fqinjët nëpërmjet telefonit për të parë nëse ata do të bëjnë pazar ushqimesh për ju. Blerjet pastaj mund të parkohen para derës tuaj.

Nëse keni nevojë urgjente për ilaçe ose trajtim mjekësor për shkak të sëmundjeve akute ose kronike, telefononi mjekun tuaj përmes telefonit dhe thoni se jeni në karantinë dhe se keni nevojë për atë që ju nevojitet.

Nëse keni një qen si kafshë shtëpiake, pyesni miqtë ose fqinjët nëse ata mund të shkojnë për një shëtitje ose ta marrin qenin me vete për momentin.

Shëtitjet dhe vizitat në terrenet e lojërave nuk lejohen në karantinë - askush nuk duhet të infektohet me ju.



## A DUHET TË PRES NDËSHKIME / GJOBA NËSE NDËRPRES KARANTINËN?

PO, këtë mund ta presësh. Nëse i thyen rregullat e Karantines (izolimit), mund të marrësh një gjobë (deri në 25.000 Euro) apo egziston mundësia edhe të burgosesh. Zyrat e rendit publik të qyteteve dhe bashkive mund të zbatojnë masa karantine në rast të shkeljes (me urdhër gjykatë). Sidoqoftë, policia mund të ndalojë menjëherë njerëzit që nuk e respektojnë urdhrin e karantinës, pasi mosrespektimi i urdhrit të karantinës është një vepër penale.




## CFARË TË BËJË NËSE GJATË KARANTINES (IZOLIMIT) SËMUREM?

Nëse gjendja juaj shëndetësore përkeqësohet ndjeshëm, atëherë telefononi mjekun tuaj të familjes. Nëse nuk mund të arrini askënd atje, telefononi në shërbimin mjekësor falas në **116 117**. Në raste urgjente, thirrni numrin e urgjencës **112**. Thuani atyre se për momentin ndodhëni në izolim shtëpiak.



## DU HAST FRAGEN ZUM CORONA-VIRUS?

- Hotline des Kreises Lippe zum Coronavirus: 05231/62-1100, montags bis donnerstags 8 bis 16 Uhr, freitags von 8 bis 13 Uhr sowie samstags und sonntags von 9 bis 13 Uhr.
- Allgemeine Corona-Hotline des Landes NRW: 0211/ 9119 1001
- Bei medizinischen Fragen und außerhalb der Sprechzeiten des Hausarztes: 116 117. Bitte wähle den Notruf nur, wenn es sich um eine akute Notlage handelt!



Burimi:

<https://www.land.nrw/de/wichtige-fragen-und-antworten-zum-corona-virus#a5bc0df5>

<https://www.kreis-lippe.de/kreis-lippe/aktuelles/corona.php>



Übrigens: Ihr findet uns jetzt auch auf Instagram und YouTube!



WIR BLEIBEN ZUHAUSE

